

V E N D I M
Nr. 734, datë 28.12.2000

**PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE DETYRAT E ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË
POPULLSISË DHE TË BANESAVE NË BASHKI E KOMUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.8669, datë 26.10.2000, "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave", me propozimin e zëvendësministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Ngritjen e komisionit të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në bashki e komuna.

1. Për organizimin dhe realizimin e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, brenda territorit të bashkisë e komunave, ngrihen zyrat e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në këto bashki e komuna.

II. Përbërja e zyrave të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në bashki dhe komuna.

1. Përbërja e zyrave të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në bashki të jetë si vijon:

- Kryetari i bashkisë	kryetar
- Përgjegjësi i zyrës së gendjes civile	anëtar
- Kontrollori	anëtar

Numri i kontrollorëve të zyrës së regjistrimit në bashki të jetë në varësi të numrit të popullsisë dhe të zonave të anketimit. Çdo kontrollor është përgjegjës për disa anketues, që kanë përgjegjësinë e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave për 80 deri në 100 familje.

2. Përbërja e zyrës së regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në komuna të jetë si vijon:

- Kryetari i komunës	kryetar
- Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile	anëtar
- Kontrollor	anëtar

Numri i kontrollorëve të zyrës së regjistrimit në komuna të jetë në varësi të numrit të popullsisë dhe të zonave të anketimit.

III. Detyrat e komisionit të regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në bashki e komuna

1. Në zbatim të udhëzimeve dhe të përcaktimeve të Institutit të Statistikave, komisioni i regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në bashki e komuna, ka këto detyra:

- merr masat e nevojshme për të siguruar zhvillimin normal të regjistrimit brenda territorit të bashkisë dhe komunës;
- jep të dhëna dhe asistencë për personelin e regjistrimit, në qytete dhe në fshatra;
- përzgjedh dhe trajnon anketuesit dhe kontrollon kryerjen e detyrave të tyre;
- raporton, një herë në javë pranë komisionit të regjistrimit në prefekturë, dhe pranë drejtorisë rajonale të statistikës për zhvillimin e procesit të regjistrimit, brenda territorit të bashkisë ose komunës. Gjatë periudhës së regjistrimit në terren raporton çdo ditë;
- merr masa për sigurimin e pranimi, në gjendje të mirë, të materialeve të regjistrimit në bashki ose komunë, depozitimin e sigurt të këtyre materialeve, vënien në dispozicion të kontrollorëve dhe anketuesve dhe kthimin e dorëzimit në kohë të materialeve, pranë komisionit të regjistrimit në prefekturë.

IV. Detyrat e personelit që kryen regjistrimin në terren.

1. Detyrat, kriteret dhe përshkrimi i vendit të punës për kryembikëqyrësit e prefekturave, për mbikëqyrësit e drejtorive rajonale të statistikës dhe për kontrollorët dhe anketuesit përcaktohen nga Instituti i Statistikave.

V. Kohëzgjatja e funksionimit të komisioneve

1. Zyrat e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave, në bashki e komuna, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre deri më 31.7.2001.

VI. Detyrimet metodologjike.

1. Zyrrat e regjistrimit të popullsisë dhe të banesave në bashki e komuna, udhëzohen për ndjekjen dhe zbatimin e veprimeve për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë e të banesave nga Instituti i Statistikave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta